

Byrosës së  
Kuvendit  
Juh

Luigi Hoxha  
Et. H. Hoxha  
për legjtimin

19.02.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

Nr. 619/3 Prot.

Tiranë, më 19.02.2024

**Lënda:**

**Ankim ndaj vendimit Nr. 54 datë 16.02.2024**

**Baza Ligjore:**

Neni 7, 25, 31, 65/2, 65/3, 65/4, 76/1, e vijues të Rregullores së Kuvendit.  
Kodi i Procedurave Administrative; Kushtetuta e RSH.

**Drejtuar:**

**Byrosë së Kuvendit të Shqipërisë.**

*Zonja Nikolla,*

Në lidhje me Vendimin Nr. 54, Nr. Prot. 619/1, datë 16.02.2024 të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën (në vijim "**Sekretariati**"), për përjashtimin nga pjesmarrja në komisione dhe në seancë plenare për me 10-ditë për Deputetet Albana VOKSHI dhe Elda HOTI, paraqesim kundërshtimet tona, sa më poshtë vijon:

1. Vendimi Nr. 54, Nr. Prot. 619/1, datë 16.02.2024 i Sekretariatit (në vijim të disa vendimeve të tjera të marra nga Sekretariati në dëm të deputetëve të Partisë Demokratike dhe të Opozitës), është **antikushtetues** dhe një **akt i rëndë ndaj parlamentarizmit** në Shqipëri;
2. Vendimi Nr. 54, Nr. Prot. 619/1, datë 16.02.2024 i Sekretariatit, shkel Nenin 70/1, 73/1, 79/1, të Kushtetutës.
3. Vendimi Nr. 54, Nr. Prot. 619/1, datë 16.02.2024 i Sekretariatit, është marrë në shkelje të Nenit 64, dhe 65 të Rregullores së Kuvendit. Deputetet Vokshi dhe Hoti kanë marrë njoftim për mbledhjen e Sekretariatit vetëm në orën 14.06, pa i dhënë asnjë mundësi deputeteve të përgatisnin provat e faktet apo të paraqiteshin në mbledhjen e Sekretariatit.
4. Mbledhja e Sekretariatit është organizuar në mohim të të drejtave të deputeteve. Vendimi Nr. 54, Nr. Prot. 619/1, datë 16.02.2024 i Sekretariatit, është marrë në shkelje të Nenit 65/2 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, në mungesë totale transparence si dhe në mungesë provave dhe fakteve.

5. Mbledhja e Sekretariatit është mbajtur on-line, në shkelje të Rregullores së Kuvendit e cila në asnjë rast nuk parashikon që mbledhjet e këtij Sekretariati, mund të mbledhen on-line.
6. Pretendimet e shtatë deputetëve (4 prej tyre zonja deputete) në adresë të dy zonjave Deputete, për “shkelje”, janë të pabazuara, tendencioze, të përgjithshme dhe të painedividualizuara sa duhet, si dhe mbi të gjitha, veprimet që atribuohen sipas kërkuesve nga dy zonjat deputete objekt i procedimit dhe/apo aktet e tyre nuk parashikohen në Rregulloren e Kuvendi si shkelje.
7. Më konkretisht, Zonjat deputete, së bashku me kolegët deputetë të opozitës, kanë protestuar paqësisht dhe qetësisht, duke qëndruar në këmbë me pankarta në duar. Kjo provohet lehtësisht, mjafton që Sekretariati të kishte administruar procesverbalet e seancës së 15 shkurtit dhe materialet video të saj. Por kjo gjë nuk ka ndodhur, sepse urdhëri për dënimin e dy deputeteve ka qenë politik dhe i paracaktuar.
8. **Përsa i përket pajisjeve zhurmuese**, tërheqim vëmendjen tuaj se sipas Rregullores së Kuvendit (*varianti i fundit*), sanksionohet me masa disiplinore përdorimi i materialeve piroteknike, por në asnjë rresht të Rregullores nuk parashikohet ndalimi i mjeteve zhurmuese. Rrjedhimisht, vendimmarrja e Sekretariatit duhet të konsiderohet e kundraligjshme për sa i takon përjashtimit të dy deputeteve, sepse ky vendim qenka miratuar mbi bazën e një veprimi që nuk parashikohet aspak si shkelje nga Rregullorja, të cilën vetë mazhoranca socialiste e votoi me dhunën e kartonave në mënyrë të njëanshme pak javë më parë.
9. Nga ana tjetër, lidhur me Znj. Albana Vokshi, **kërkuesit kanë pretenduar se deputetja ka përdorur “gjuhë joparlamentare” ndaj drejtueses së seancës. Kjo është totalisht e pavërtetë, e paargumentuar dhe e paprovuar.** Kjo për faktin e vetëm që në asnjë rast, znj. Vokshi, edhe pse ndaj të cilës shpesh është përdorur gjyhtë fyese dhe jo-parlamentare nga ana e Kryeministrit Edi Rama apo Ministrave të Qeverisë, në asnjë rast nuk do të përdorte ndaj një zonje tjetër gjuhë të papërshtatshme, aq më pak jo-parlamentare. Seanca e datës 15 shkurt zgjati vetëm pak minuta. Për fat ajo u pasqyrua gjerësisht nga shumë media të vendit. Pamjet e asaj seance janë publike dhe transparenca mund të bëhet në çdo moment. Aty shihet mjaft qartë se pretendimi i kërkuesve është një shpifje e ulët dhe e pabazë.
10. Deputetët kërkues, kryesisht zonjat deputete të PS, do të duhet të shqetësoheshin për gjuhën e përdorur rëndom në Kuvend, nga ana e Kryeministrit Edi Rama, e mbushur me sharje, ofendime dhe bullizime. Edi Rama, ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme dhunë verbale, psikologjike ndaj deputetëve të opozitës. E nëse deputetët kërkues (kryesisht zonjat deputete të shqetësuara nga “gjuha jo-parlamentare”) do të qëndronin në lartësinë e tyre të përfaqësimit, do të duhet të kishin dërguar dhjetëra kërkesa për përjashtim të Edi Ramës nga seancat plenare.
11. *A është e mundur të dënohet dikush për diçka që nuk parashikohet si shkelje apo nuk provohet?! Nëse kjo ndodh, atëherë, jo vetëm që kjo përbën dhunim të Kushtetutës, të*

Rregullores së Kuvendit, por kemi të bëjmë me kryerje të veprimeve arbitrare, zbatim verbërisht të urdhërave politike, duke u munduar që t'i mbyllin gojën opozitës.

12. Nëse Sekretariati do të kishte zbatuar drejt Rregulloren dhe ligjet në fuqi, minimalisht do të kishte kërkuar prova ose të paktën do të kishte administruar procesverbalin e seancës, apo pamjet video të saj, për të kuptuar saktë nëse pretendimet e kërkuesve qëndronin apo jo. Duke mos vepruar kështu, Sekretariati thjesht ka “noterizuar” një vendim të paragjykuar dhe të marrë tashmë nga tjetërkush, duke injoruar procedurën, rregulloren e Kuvendit dhe duke vendosur në mënyrë arbitrare përjashtimin e dy zonjave deputete me 10-ditë.
13. Një tjetër abuzim me të drejtën, është edhe llogaritja e afatit nga kur nis sanksioni në fjalë. Me qëllim që përjashtimi të zgjatet tej afatit 10-ditor, ndonëse vendimi u mor të premtën datë 16 shkurt dhe po atë ditë u krye edhe komunikimi i vendimit, çuditërisht “hyrja në fuqi” e vendimit caktohet në datë 19 Shkurt (ditë e hënë). Kjo kryhet vetëm me qëllimin që përjashtimi i deputeteve të nisë me 3-ditë vonesë dhe të zgjasë më gjatë. Nuk është hera e parë që këto abuzime ndodhin me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit nga ana e Sekretariatit, i cili është keqpërorur në mënyrën më të ulët kohët e fundit nga sejmënët e Edi Ramës.
14. Përsa i përket provave dhe fakteve nga ana jonë, edhe pse ato gjenden në të gjitha mediat kombëtare e lokale (të cilat e kanë transmetuar live seancën plenare të datës 15.02.2024), në RTSH Kuvend, si dhe në rrjetin zyrtar social të Kuvendit të Shqipërisë, theksojmë që në shkelje të Rregullores së Kuvendit, deputeteve Vokshi dhe Hoti nuk ju dha asnjë mundësi për t'i paraqitur ato në mbledhjen e Sekretariatit.

Deputetët e opozitës, kanë qenë në kërkim të të drejtave të tyre procedurale, të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit, që janë shkelur e penguar në mënyrë të vazhdueshme e të përsëritur në të gjitha seancat e fundit plenare nga organet drejtuese të Kuvendit.

Përdorimi i masave ekstreme disiplinore në grup, të painedividualizuara, pa prova dhe fakte, në mënyrë të vazhdueshme e joproporcionale, është bërë qëllimisht për të ndikuar në aftësitë e opozitës për të ushtruar të drejtat kushtetuese në seancat plenare dhe në komisione.

Përsa më sipër, Vendimi Nr. 54, Nr. Prot. 619/1, datë 16.02.2024 i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën është një akt antikushtetues, antiligjor; është një goditje e rëndë për parlamentarizmin në Shqipëri.

Neni 65/2 “Shqyrtimi dhe marrja e vendimit nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën”, pika 2, përcakton: **Shqyrtimi i çështjes kryhet nëpërmjet një procedure që i garanton të drejtën e deputetit për t'u informuar për kërkesën, për t'u pyetur, për t'u dëgjuar, për të paraqitur shpjegimet e tij, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, për t'u njohur me provat dhe dokumente të tjera.**


Asnjë prej deputetëve për të cilët është marrë masa disiplinore, nuk është informuar në kohë për mbledhjen e mbledhur në mënyrë urgjente e jo transparente. Asnjë deputeti nuk i është dhënë mundësia reale dhe e drejta e përcaktuar në këtë nen për t'u pyetur, për t'u dëgjuar, për të paraqitur shpjegimet e tij. Kjo e ka shndërruar Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën në një organ censure, për t'i mbyllur gojën opozitës, dhe mbledhjen e tij e ka shndërruar në një gjyq politik ku dënohen vetëm deputetët e opozitës. Dhuna dhe xhestet jo etike dhe joparlamentare të kryera nga Edi Rama apo deputetët e tij, nuk shihen dhe as ndëshkohen ndonjëherë nga Sekretari i Etikës. Rregullorja e Kuvendit nuk ka asnjë nen që parashikon vendimin për dënim në grup, për protesta demokratike që e gjithë bota demokratike i njeh.

Ndaj, bazuar në Nenet 65/3, 65/4 e vijues të Rregullores së Kuvendit, nga Byroja e Kuvendit, kërkojmë:

- **Shfuqizimin e menjëhershëm të vendimit Nr. 54, Nr. Prot. 619/1, datë 16.02.2024 i Sekretariatit;**
- **Pezullimin e Vendimit deri në marrjen e vendimit nga Byroja e Kuvendit,** bazuar në Nenin 65/3, pika 4 i Rregullores së Kuvendit që përcakton: *“Me paraqitjen e ankimit ...vendimi i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën pezullohet me vendim të ndërmjetëm të Byrosë së Kuvendit deri në dhënien e vendimit përfundimtar”.*
- **Zbatimin rigoroz të procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit** sipas Nenit 65/4, pika 1/b, pika 1/c, pika 2, që përcakton: *“procedurën që i garanton të drejtën cdo deputeti për t'u informuar për kërkesën, për t'u pyetur, për t'u dëgjuar, për të paraqitur shpjegimet e tij/saj”.*
- **Mbledhja e Byrosë së Kuvendit të zhvillohet fizikisht** e deputetëve për të cilën Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën ka marrë masë disiplinore me anë të vendimit nr. 54, datë 16.02.2024, t'u jepet mundësia të jenë prezent në mbledhjen e Byrosë për të dhënë faktet dhe argumentat e tyre.
- **Mbledhja e Byrosë së Kuvendit të jetë e hapur për mediat dhe publikun.**

Kryetarja e Kuvendit, në zbatim të Rregullores së Kuvendit, të marrë të gjitha masat e duhura për respektimin e të drejtave të deputetëve.

DEPUTETET

Elda Hoti 

Albena Uchaku' 